AKFAL

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE**

| Nr. rendor | Data e kërkesës | Objekti i kërkesës | Data e përgjigjes | Përgjigje | Mënyra e përfundimit të kërkesë | Tarifa |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | 03.07.2023 | Ankesë e studentes përfituese e mbështetjes studentore, e cila parashtron se nuk na kane kaluar deri tani 7 muaj me nga 340 mij duke na llogaritur edhe muajin prill 340 dhe jo 400 sa duhet. | 06.07.2023 | Në përgjigje të ankesës suaj, administruar në rrugë elektronike pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, ju bëjmë me dije se:<br>AKFAL është dukë ndjekur ankesën tuaj, si dhe e ka përcjellë atë pranë Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër më datë 06.07.2023.<br>Në përfundim ju do të informoheni nga ana jonë në lidhje me trajtimin dhe përfundimet e arritura pas shqyrtimit.<br>Studentia është informuar pas përgjigjes së USH-së. | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 6 | 08.07.2023 | Kërkesë për informacion nese muaji qershor eshte i perfshire ne marrjen e burses per studentet e degeve prioritare, pasi ne kontrate thuhet se eshte e vlefshme aq sa vazhdon frekuentimi i institucuonit dhe deges. | 14.07.2023 | Në vijim të kërkesës suaj për informacion në lidhje me periudhën e përfitimit të mbështetjes financiare për një vit akademik ju bëjmë me dije se:<br>Referuar marrëveshjes trepalëshe, përfituesi financohet në nivelin e pagës minimale në shkallë vendi, për çdo muaj të frekuentimit të procesit mësimor të vitit akademik 2022-2023, si dhe të viteve akademike pasardhëse, sipas kalendarit të vitit akademik për programin përkatës të studimit, por jo më shumë se 10 muaj kalendarik, pas konfirmimit të frekuentimit të programit përkatës të studimit nga institucioni publik i arsimit të lartë, ku është regjistruar përfituesi.<br>Në lidhje me kohëzgjatjen e procesit mësimor, për çdo program studimi miratohet plani mësimor nga Fakulteti përkatës i çdo IAL-je.<br>Sa më sipër, ju mund të drejtoheni pranë Fakultetit në të cilin ndiqni studimet me qëllim informimin për çështjen e parashtruar nga ana juaj.<br>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 7 | 14.07.2023 | Kërkesë për informacion në lidhje me efektet e ndryshimeve në VKM nr.386/2022, për heqjen e mesatares për të vijuar përfitimin e bursës në masën pagës minimale në rang vendi, për studentët që ndjekin programe prioritare në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. | 20.07.2023 | Përshëndetje.<br>Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju bëjmë me dije se:<br>Bazuar në pikën 2 të VKM-së nr.379, datë 29.06.2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 386, datë1.6.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e fushave dhe të programeve të studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar,dhe mbështetjen financiare të studentëve të shkëlqyer e të studentëve, që ndjekin këto programe në institucionet publike të arsimit të lartë", heqja e mesatares për studentët që përfitojnë mbështetje financiare, pasi kanë zgjedhur të ndjekin një prej programeve të studimit, që përbën prioritet kombëtar, fillon efektet nga viti akademik 2023–2024 e në vijim.<br>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 8 | 17.08.2023 | Duke marre shkas nga njoftimi i bere nga Znj. Evis Kushi, mbi miratimin e skemes se kredise studentore, e cila do te zbatohet ne vitin e ri akademik 2023 – 2024, ju lutem konsideroni nepermjet kesaj korrespondence kerkesen e Intesa Sanpaolo Bank Albania per te zhvilluar nje takim me te detajuar rreth kesaj ceshtje.<br>Duke vleresuar kohen tuaj, ju lutem na beni me dije nese nen Agjencine tuaj ka strukture te dedikuar me te cilen duhet te vendosim kontakte per te marre informacionin e nevojshem.<br>Mbetemi ne pritje te kontaktit nga ana juaj.<br>Duke ju falenderuar paraprakisht, Ju uroj nje vere te kendeshme! | 17.08.2023 | Përshëndetje,<br>Fillimisht ju falënderojmë për shprehjen e interesit nga ana juaj, mbi Skemën e Kreditimit Studentor.<br>Në zbatim të pikës 3, të VKM-së nr.440/2023, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, së shpejti do të fillojë procesin e negocimit me bankat e nivelit të dytë për dhënien e kredive studentore, mbi bazën e kushteve të parashikuara në këtë vendim.<br>Në vijim të kërkesës suaj për të zhvilluar një takim më të detajuar rreth kredisë studentore, ju bëjmë me dije se, ju do të njoftoheni nga AKFAL në momentin më të parë mbi fillimin e procesit të negocimeve.<br>Sa më sipër, bashkëlidhur ju përcjellim për dijeni, Vendimin nr.440, datë 19.07.2023 "Për përcaktimin e skemës së kreditimit studentor".<br>Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 9 | 28.08.2023 | Kërkesë për informacion Universiteti i Vlorës në lidhje me Udhëzuesin mbi formën dhe mënyrën e raportimit, në zbatim të Udhëzimit nr.5/2018 të MAS. | 01.09.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të e-mail-it tuaj, bashkëlidhur ju përcjellim tabelat e kërkuara në format exel.<br>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 10 | 03.09.2023 | Po ju drejtohem për sa i përket bursës së ministrisë së arsimit për studentët të cilët do të zgjedhin një nga degët që cilësohen si prioritet kombëtar.Si student i ardhshëm i arsimit të lartë,nismën tuaj për heqjen e tarifave dhe caktimin e një burse mujore sa paga minimale për këdo student që zgjedh një nga degët prioritare,e përgëzoj.Është një nga vendimet më atraktive të ministrisë së arsimit deri tani dhe i vjen në ndihmë shumë studentëve.Unë po e konsideroj regjistrimin në një nga degët prioritare por arsyeja se pse kam pritur është për shkak të disinformimit në Internet.Disa media japin një listë tjetër për degët prioritare ku disa mungojnë,disa të tjera japin lista të përditsuara ku janë shtuar disa degë si histori-gjeografi,inxhineri..etj.Unë do kërkoja nga ju dhe nga AKFAL për një listë të vërtet të degëve prioritare si dhe një shpjegim se si mbas regjistrimit në një nga kto degë në universitet mund ta marrim këtë bursë,pra procedurat,kontratat,protokollet. | 11.09.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion në lidhje me mbështetjen studentore, ju bëjme me dije se:<br>Fushat dhe programet e studimit, që përbëjnë prioritet kombëtar, janë miratuar me VKM-në nr. 386 datë 01.06.2023, të ndryshuar me VKM-në nr. 397/2023. Lista e programeve prioritare aktuale pasqyrohen në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet VKM-së nr. 397/2023.<br>Procedura dhe hapat që ndiqen për realizimin e mbështetjes studentore janë përcaktuar shprehimisht në Udhëzimin nr. 30 datë 04.11.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.<br>Sa më sipër, bashkëlidhur po ju përcjellim VKM-në nr. 397/2023 dhe Udhëzimin nr. 30/2022, të MAS.<br>Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, | | Jo |
| 11 | 12.09.2023 | Pershendetje,<br>Cfare dokumenti perfshin pika:<br>2-Vërtetim për shlyerjen e të gjithë detyrimeve për vitin akademik 2022-2023. Ky vertetim duhet plotesuar nga Universiteti?<br>Pune te mbare! | 12.09.2023 | Pershendetje,<br><br>Vërtetim për shlyerjen e të gjithë detyrimeve për vitin akademik 2022-2023, duhet të këtë përmbajtje:<br><br>Vërtetojme se studenti _______________, me nr.matrikullimi ___________, në programin e studimit _____________, të Fakultetit ______________, të IAL _________________, ka shlyer të gjitha detyrimet e vitit akademik 2022-2023.<br><br>Vërtetimi mbi shlyerjen e detyrimeve do të lëshohet nga IAL-ja në të cilin ju ndiqni studimet. Ju (studenti) duhet ti depozitoni aktet ,pas pajisjes me to nga IAL-ja, pranë AKFAL.<br>Falemiderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 12 | 12.09.2023 | Pershendetje!<br>Arsyeja qe po ju shkruaj eshte sepse gjate vitit te pare akademik nuk kam arritur te ruaj mesataren qe diktohet ne kontrate.<br>Si rrjedhoje, duhet t'i dorezoj dokumentat ne AKFAL, apo nuk eshte e nevojshme?<br>Sinqerisht<br>Jubiana Koçiu | 12.09.2023 | Pershendetje,<br><br>Te gjithe studentet te cilet kane nenshkruar marreveshjen trepaleshe duhet te dorezojne prane AKFAl, dokumentat e kerkuara.<br><br>Ju falemiderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 13 | 16.09.2023 | Pershendetje<br>Une i kam derguar dokumentet qe me keni kerkuar me rruge postare. Dokumentin e shlyerjes se detyrimeve te vitit te pare kur shkova te sekretarja ta nxirrja, ajo me tha qe po te leshoj nje dokument se je studente e ketij universiteti sepse kete dokument qe kerkon nuk mund ta nxjerr pa filluar viti i ri shkollor. Dokumentet qe ju kam derguar i keni marre dhe nqs po a jane sakte apo duhen bere te tjera? | 19.09.2023 | Përshëndetje,<br><br>Në përgjigje të email-it tuaj, ju bëjmë me dije se pranë AKFAL janë administruar dokumentet e paraqitura nga ana juaj dhe nuk është i nevojshëme depozitimi i akteve të tjera.<br><br>Ju falemiderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |
| 14 | 22.09.2023 | Pershendetje jam studente e matematikes ne Universitetin e Shkodres, desha tju pyesja nese kane ardhur dokumentet edhe jane te sakta. Faleminderit ! | 28.09.2023 | Përshëndetje,<br>Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju bëjmë me dije se dokumentacioni juaj është administruar pranë AKFAL dhe dokumentat janë duke u shqyrtuar nga struktura përkatëse.<br>Sa më sipër, ju do të njoftoheni në lidhje me përfundimet e arritura pas verifikimit.<br>Ju falëminderit, | Përgjigjia jepet e plotë | Jo |